



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 730 Prot.

Tiranë, më 01.12.2016

**V E N D I M**

**Nr. 149, datë 01/12/2016**

**“Për përfundimin e procesit të verifikimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1,14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit me shkresën nr. 453/17, dt. 23.09.2016, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 87, dt.22.07.2016 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**Vërejt se:**

Me Vendimin Nr. 139, datë 30.12.2015 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil”, Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar mbikëqyrjen e përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 87, datë 22.07.2016 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil” të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.

2. Institucioni i mbikëqyrur t'i kërkojë njësisë përgjegjëse, (DAP), që të japë mendimin lidhur me përshkrimet e punës nëse janë të hartuara në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse, të vijojë procesin duke nënshkruar përshkrimet e punës në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja "c", të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

4. Nëpunësit civilë në periudhë prove, të vendosen nën kujdesin e nëpunësit më të vjetër civil. Në përfundim të periudhës së provës, mendimi me shkrim i nëpunësit më të vjetër duhet të bëhet pjesë e procedurës së konfirmimit të nëpunësit civil.
5. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, të nxjerrë vendimin për deklarimin e shuarjes së masës disiplinore "Vërejtje", të marrë për nëpunësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*.

Masa disiplinore "Vërejtje", të fshihet nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës.

6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të mësipërm, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit me shkresën nr. 453/17 prot., dt.23.09.2016, informon Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 87, dt.22.07.2016. Së bashku me informacionin e dërguar është paraqitur dhe dokumentacioni shkresor, me anë të të cilit institucioni pretendon të provojë zbatimin e vendimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit shkresor të administruar nga ana e Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, rezultoi se:

Institucioni, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, me urdhërin nr. 102, datë 15.08.2016, "Mbi planin e veprimit për zbatimin e detyrave dhe vendimeve të lëna me Vendimin Nr. 87, datë 22.07.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil 'Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit" ka urdhëruar njësinë përgjegjëse, që të zbatojë të gjitha rekomandimet e Komisionerit dhe të bashkëpunojë me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, në përputhje me dispozitivin e Vendimit Nr. 87, datë 22.07.2016. Konkretisht:

- ✓ Njësia përgjegjëse në zbatim të pikës 2 dhe 3 të vendimit, me shkresën nr. 453/10, datë 20.07.2016, *“Mbi përshkrimet e pozicioneve të punës”*, ia ka dërguar përshkrimet e punës për miratim Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky i fundit, me shkresën nr. 4258/4 prot., datë 29.07.2016, *“Kthim për plotësim dhe korrigjim i përshkrimeve të punës”*, i ka sugjeruar njësisë përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit kryerjen e disa korrigjimeve në përshkrimet e punës. Më tej, me shkresën nr. 453/16 prot., datë 22.09.2016, *“Ridërgim të përshkrimeve të punës”*, përshkrimet e korrigjuara i janë dërguar Sekretarit të Përgjithshëm për miratim. Vlerësojmë se njësia përgjegjëse e ka përmbushur rekomandimin e Komisionerit në përputhje me dispozitivin e Vendimit Nr. 87, datë 22.07.2016, të tij. Gjithsesi, kjo pikë e vendimit do të verifikohet më tej, deri në përmbylljen e plotë të të gjithë procesit, me miratimin e përshkrimeve të punës nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Departamenti i Administratës Publike.
- ✓ Në zbatim të pikës 4, të Vendimit Nr. 87, datë 22.07.2016, të Komisionerit, njësia përgjegjëse bazuar në Vendimin nr. 243, dt.13.03.2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, të Këshillit të Ministrave, me shkresën nr. 453/18 prot., datë 23.09.2016 *“Për mbikëqyrjen e nëpunësit civil, \*\*\*\*\* gjatë periudhës së provës”* dhe shkresën nr. 453/1/19 prot., date 23.09.2016 *“Për mbikëqyrjen e nëpunësit civil, \*\*\*\*\* gjatë periudhës së provës”*, i ka vendosur nëpunësit civilë në periudhë prove nën kujdesin e nëpunësve civilë më të vjetër.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 5, Vendimit Nr. 87, datë 22.07.2016, të Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, me Vendimin nr. 453/5 prot., datë 24.06.2016 vendosi shuarjen e masave disiplinore *“Vërejtje”* për të gjithë nëpunësit e cituar në raport dhe fshirjen e tyre nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës sipas rekomandimeve të Komisionerit (kjo masë, nga ana e institucionit, është marrë pas njohjes me konkluzionet e projektraportit, por për këtë veprim Komisioneri nuk është vënë në dijeni).

Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi Nr. 87, datë 13.07.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit*, është zbatuar në tërësi, nga ana e subjektit.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 87, datë 22.07.2016, në institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar në tërësi rekomandimet e Vendimit Nr. 87, datë 22.07.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit”*
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti i Administratës Publike, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**